



BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Maj 2021

BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Maj 2021

AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

(Në edicionin e këtij buletini të përmuajshëm pasqyrohen aktivitetet për muajin maj 2021)

Reagim i Këshilli Prokurorial i Kosovës

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka reaguar ndaj artikullit "Pazaret" në drejtësi, Haxhiu e shqetësuar me "grupet e fuqishme" brenda KPK-së dhe KGJK-së", të publikuar më 6 maj 2021, në mediumin "Koha.net", si dhe ndaj deklarimeve të Ministres së Drejtësisë, Albulena Haxhiu, e cila kishte aluduar në kinse "grupe të fuqishme" dhe "pazare" brenda sistemit prokurorial.



KPK-ja, ka vlerësuar se ky artikull, i cili shfaq paragjykimet për kinse "manipulime" për zgjedhjen e pozitave menaxheriale nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, në këtë rast të pozitës së Kryeprokurorit të Shtetit, është i pavërtetë dhe krejtësisht tendencioz.

Në këtë kontekst, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka pranuar me shqetësim deklaratimet e Ministres së Drejtësisë, Albulena Haxhiu, të cilat si të tilla janë krejtësisht të pabazuara dhe bien ndesh me ndarjen e pushteteve, duke përbërë kështu ndërhyrje të drejtpërdrejtë në punën e Gjyqësorit, përkatësisht sistemit prokurorial.

Prandaj, një Ministre e Drejtësisë, e cila thirret në forcimin e sundimit të ligjit duhet të përmbahet nga deklaratimet e tilla të paqëndrueshme. Me këtë rast e ftojme të njëjtën që të tregojë konkretisht se për çfarë grupesh të fuqishme dhe pazaresh bëhet fjalë?!

Zgjedhja e cilësdo pozitë nga ana e Këshillit Prokurorial të Kosovës, përfshirë këtu zgjedhjen e kryeprokurorëve të prokurorive përkatëse dhe Kryeprokurorit të Shtetit, bëhet në bazë të Kushtetutës, ligjit, meritokracisë, transparencës,

monitorimit të partnerëve ndërkombëtarë dhe standardeve më të larta profesionale, e jo nga dëshirat e partive politike, individëve të caktuar dhe grupeve të interesit.

Këshilli Prokurorial i Kosovës si organ i pavarur dhe i paanshëm nuk do të lejojë asnjë interferim, tendencë apo çfarëdo interesi nga jashtë të ndikojë dhe cenojë integritetin e proceseve të rëndësishme, të cilat zhvillohen brenda kompetencave kushtetuese dhe ligjore.

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Jetish Maloku, është takuar me Kryetarin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë së Shqipërisë, Gent Ibrahimimi

Në këtë takim, Kryesuesi Maloku njoftoi Kryetarin Ibrahimimi për punët dhe aktivitetet që janë duke u realizuar në sistemin prokurorial, me qëllim të forcimit të sundimit të ligjit në Kosovë, duke potencuar se është i përkushtuar në zbatimin e misionit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.



Dy bashkëbiseduesit diskutuan për çështjet me interes të përbashkët, përfshirë shkëmbimin e përvojave për reformat në sistemin e drejtësisë.

Kryetari Ibrahimimi theksoi se reforma në drejtësi në Shqipëri ka pasur fillimisht disa pengesa, të cilat janë tejkaluar dhe tashmë ky proces është duke shkuar në rrugën e duhur. Ai potencoi se është i gatshëm të ofrojë mbështetjen e tij profesionale dhe institucionale për reformat e parapara në sistemin e drejtësisë në Republikën e Kosovës.

Dy bashkëbiseduesit vlerësuan se konsolidimi i institucioneve të sistemit të drejtësisë, përfshirë një shërbim efikas të sistemit prokurorial, janë baza për një sundim të fortë të ligjit, duke iu dhënë besim qytetarëve në institucionet e drejtësisë.

Kryesuesi Maloku dhe Kryetari Ibrahimimi u zotuan se do të intensifikojnë takimet në bazë të zhvillimit të

dinamikës së punëve, me qëllim të shkëmbimit të përvojave në reformat në drejtësi.

Diskutohet avancimi i ndërlidhjes për shkëmbimin elektronik të të dhënave

Zëvendëskryesuesi i KPK-së, njëherësh kryesuesi i Komisionit për Administrim të Prokurorive, Veton Shabani, është pritur në takim nga Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Fehmi Hoti, me ç'rast



temë e diskutimit ishte avancimi i ndërlidhjes për shkëmbimin elektronik të të dhënave në relacionet në mes të prokurorive dhe policisë.

Gjatë takimit, u tha se shkëmbimi i plotë i të dhënave në mes të prokurorisë dhe policisë sjellë përfitime shumë të mëdha për të dyja institucionet, prandaj avancimi i sistemeve është prioritet i përbashkët, duke konstatuar se është e nevojshme që për module të caktuara të sistemeve elektronike të ketë avancim të shkëmbimit të të dhënave, me qëllim të arritjes së plotë të digjitalizimit të procesit të punës.

Nga muaji shkurt 2020 ka filluar së zbatuari shkëmbimi elektronik i të dhënave në mes të prokurorive dhe policisë.

Prezantohet Raporti special i EULEX-it për ndikimin e Covid-19 në sundimin e ligjit në Kosovë

Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX) organizoi një konferencë, në të cilën prezantoi Raportin special për ndikimin e COVID-19 në sundimin e ligjit në Kosovë. Në mesin e pjesëmarrësve ishin Shefi i këtij misioni, Lars-Gunnar Wigemark, Kryesuesi i KPK-së, Jetish Maloku, Kryesuesi i KGJK-së, Skender Çoçaj dhe përfaqësues të tjerë të mekanizmave vendorë dhe ndërkombëtarë në Kosovë.

Shefi i EULEX-it, Lars Gunnar Wigemark, shprehu vlerësimin e tij për menaxhimin e mirë të pandemisë nga ana e institucioneve të sistemit të drejtësisë në

Kosovë. “Shtirirja e pandemisë na ka befusuar të gjithëve, por jam i befusuar se si institucionet e Kosovës janë ambientuar dhe me këtë situatë, duke e trajtuar pandeminë me seriozitet”, tha ai.



Kurse, Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Jetish Maloku, gjatë fjalës së tij të rastit, tha se mirëpret këtë raport të çmuar, duke potencuar se COVID-19 vazhdon të ketë ndikim në funksionimin e institucioneve të sundimit të ligjit. “Pandemia COVID-19, ashtu sikurse edhe në çdo sferë jetësore, edhe në sistemin prokurorial të Kosovës, ka pasur efekte negative. Ky raport për ndikimin e COVID-19 në sundimin e ligjit në Kosovë është shumë i rëndësishëm për ne dhe publikohet në momentin e duhur”, tha Kryesuesi Maloku, duke vazhduar më tej se “Këshilli Prokurorial dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, në bashkëpunim me projektin britanik ‘Forcimi i sistemit të drejtësisë në Kosovë’, kanë hartuar Planin për menaxhimin e krizave në sistemin prokurorial dhe kanë përgatitur Udhëzuesin e përkohshëm për mbrojtje nga virusi COVID 19 në sistemin prokurorial të Kosovës”.

Në përmbyllje, pjesëmarrës të tjerë të këtij evenimenti, thanë se raporti rrjedhimisht ofron rekomandime konkrete dhe të zbatueshme për sistemin e sundimit të ligjit në Kosovë për t’u përgjigjur sa më mirë ndaj krizës shëndetësore që po vazhdon, me ç’rast veçanërisht vlen të përmenden një nga rekomandimet kryesor në këtë raport i të rëndësishëm, i cili nënvizon se autoritetet kosovare të drejtësisë në Kosovë duhet të reagojnë në përputhje me rrethanat, duke baraspeshuar ndikimin e masave kufizuese mbi të drejtat e tjera të njeriut dhe sundimin e ligjit në përgjithësi.

Intervistohen kandidatët për Kryeprokuror të Prokurorisë Themelore të Gjakovës

Këshilli Prokurorial i Kosovës intervistoi kandidatët për Kryeprokuror të Prokurorisë Themelore të Gjakovës, me anë të Panelit, i cili përbëhej nga pesë anëtarë të KPK-së dhe kryesohet nga Kryesuesi Jetish Maloku.



Prokurorja Dëshirë Jusaj dhe prokurori Ramiz Buzhala ishin dy kandidatët që i kanë hyrë garës për Kryeprokuror të Prokurorisë Themelore të Gjakovës.

Paneli, pas procesit të intervistimit, vlerësimit dhe arsyetimit, Këshilli Prokurorial të Kosovës i propozon kandidatin e suksesshëm për votim.



Procesi i intervistimit të kandidatëve për Kryeprokuror të Prokurorisë Themelore të Gjakovës është monitoruar nga partnerët ndërkombëtarë dhe OJQ-ja “Grupi për Studime Juridike dhe Politike”.

Kryesuesi Maloku: KPK-ja do të angazhohet maksimalisht për përmbushjen e obligimeve në procesin e integriteteve evropiane

Kryesuesi i KPK-së, Jetish Maloku, mori pjesë në takim të Këshillit Ministror për Integrim Evropian, i kryesuar nga Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, me ç’rast u diskutuan prioritetet për fazën e dytë të Planit të Veprimit të Agjendës për Reformën Evropiane (ERA).

Kryesuesi Maloku, në fjalën e tij, tha se Këshilli Prokurorial i Kosovës, përmes njësive dhe strukturave të brendshme, në bashkëpunim me strukturat relevante të Zyrës së Kryeministrit, ka ofruar kontributin e vet në përcaktimin e prioritetëve dhe propozimin e masave, aktiviteteve dhe indikatorëve, të cilët do të përfshihen në fazën e dytë të Agjendës për Reformën Evropiane.



Po ashtu, Kryesuesi Maloku, u zotua se, pas miratimit të Planit të veprimit, KPK-ja do të vazhdojë angazhimin maksimal në përmbushjen e plotë të këtyre obligimeve, në mënyrë që sistemi prokurorial të japë kontributin e tij në procesin e integritetit evropian të vendit.

Në fokus të KPK-së, mbikëqyrja e Njësitit për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike

Grupi punues për mbikëqyrjen e Njësitit për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike mbajti takimin e parë me përbërjen e re, pas zgjedhjes së prokurorit Veton Shabani në dëlësinë e kryesuesit të këtij grupi.



Në fillim të këtij takimi, kryesuesi i ri i grupit punues, tha që së bashku do të punojnë për të ofruar mbështetje dhe do të jenë sa më aktivë në realizimin e mandatit, i cili del nga Plani strategjik i sistemit prokurorial për vitet 2019-2021.

Ky takim shërbeu për të diskutuar edhe për objektivat dhe harmonizimin e aktiviteteve, të cilat janë paraparë të realizohen nga ky grup punues, me ç'rast është vlerësuar puna e grupeve punuese paraprake në hartimin e raporteve dhe rekomandimet e dhëna në këto raporte.

Sipas planit të punës së këtij grupi, parashihet që shumë shpejtë të fillojë aktiviteti i mbledhjes së të dhënave për rastet e korrupsionit dhe krimeve ekonomike nëpër prokurori.

Mbahet takimi i radhës i Komisionit për Administrimin e Prokurorive

Komisioni për Administrimin e Prokurorive, i udhëhequr nga prokurori Veton Shabani, mbajti takimin e radhës, në të cilin u diskutua për harmonizimin e regjistrave të



lëndëve në Prokurorinë Themelore të Gjakovës. Këto diskutime kanë ardhur pas raportimit të Drejtorit të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë, Valon Jupa, lidhur me këto regjistra.

Me tej, udhëheqësi i Departamentit të Teknologjisë Informative, Nexhat Haziri, para anëtarëve të Komisionit prezantoi gjendjen e teknologjisë informative dhe pajisjeve të nevojshme për zbatimin e SMIL-it në të gjitha prokuroritë.

Anëtarët e Komisionit për Administrimin e Prokurorive diskutuan edhe për raportet e prokurorive lidhur me menaxhimin e pandemisë COVID-19 dhe zbatimin e Planit për menaxhimin e krizave në sistemin prokurorial.

Takohen Kryesuesi Maloku dhe Ambasadori Davenport, diskutojnë për bashkëpunimin e mëtejshëm

Kryesuesi i KPK-së, Jetish Maloku, priti në takim Shefin e OSBE-së në Kosovë, Ambasadorin Michael Davenport, të cilin e njoftoi me të arriturat dhe avancimin e kapaciteteve profesionale dhe administrative të sistemit prokurorial, me ç'rast tha se OSBE-ja në Kosovë ka dhënë një kontribut të rëndësishëm përmes mbajtjes së trajnimeve specifike dhe mbështetjes së Këshillin Prokurorial dhe Prokurorit të Shtetit në hartimin e planeve strategjike,

objektivave, akteve dhe udhëzuesve praktikë të punës.



Për më tepër, Kryesuesi Maloku shprehu mirënjohjen e tij edhe për mbështetjen e OSBE-së në hulumtimet dhe monitorimin e rasteve të dhunës në familje, hartimin e raporteve monitoruese dhe hartimin e Strategjisë kundër trafikimit të njerëzve, ku pjesë e këtij autoriteti është Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave dhe Prokurori i Shtetit, si dhe hartimin e procedurave standarde të veprimit për viktimat e trafikimit.

Kurse, Ambasadori Davenport, theksoi vullnetin e tij dhe organizatës që drejton për t'i mbështetur proceset e përbashkëta, në mënyrë që të realizohen synimet dhe të arrihet progresi i nevojshëm për zhvillim e sistemit prokurorial, me ç'rast do të përfitojnë të gjithë qytetarët e Kosovës, pa dallim.

KPK zgjedh Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Gjakovë

Këshilli Prokurorial i Kosovës, i udhëhequr nga Jetish Maloku, ka zhvilluar takimin e 199-të me radhë, në të cilin fillimisht u miratua Rregullorja për Dosjen e Prokurorëve që përcakton krijimin, përmbajtjen, mënyrën e ruajtjes, qasjes dhe menaxhimin e dosjes personale të Prokurorit të Shtetit.

Gjithashtu, në takimin e sotëm, KPK-ja zgjodhi prokurorin, Ramiz Buzhala, Kryeprokuror të Prokurorisë Themelore në Gjakovë dhe mori vendim për shpalljen e konkursit për avancimin e një prokurori në Departamentin për të Mitur të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, si dhe shqyrtoi dhe miratoi listën e kandidatëve të përzgjedhur për ndjekjen e programit Master në Universitetin "Wake Forest" në SHBA, program ky, i cili mbështetet nga Ambasada Amerikane, kurse përfitues të këtij programi për vitin 2021-2022 janë një prokuror nga Prokuroria Speciale dhe një bashkëpunëtorë profesionale nga Prokuroria Themelore në Ferizaj.

Po në këtë takim, Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të KPK-së, Valdrin Krasniqi, ka prezantuar raportimet e kryeprokurorëve të prokurorive të Republikës së Kosovës për periudhën janar-mars 2021.

Për arsye të skadimit të mandatit të Drejtorit të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë, KPK-ja shpalli konkurs për këtë pozitë dhe caktoi ushtruesen e detyrës deri në zgjedhjen e drejtorit të këtij Njësi.



Në fund, KPK-ja mori vendim për avancimin e një prokurori në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, një prokurori në Departamentin për Krime të Rënda në Prokurorinë Themelore në Pejë, një prokurori në Departamentin për të Mitur në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, dy prokurorëve në Departamentin për Krime të Rënda në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, një prokurori në Departamentin për të Mitur në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, një prokurori në Departamentin për Krime të Rënda në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, si dhe për transferimin e përhershëm të një prokurori në Departamentin për Krime të Rënda në Prokurori në Themelore në Gjakovë.

Aktivitetet e Sekretariatit të KPK-së

Në muajin maj janë zhvilluar aktivitete të ndryshme në kuadër të Sekretariatit të KPK-së, si vijojnë më poshtë:

Është mbajtur një takim me përfaqësues të projektit britanik dhe projektit të BE-së, si dhe me Drejtorin e Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës, me qëllim të realizimit të vendimit të KPK-së dhe është përfunduar vizita me rastin e auditimit në PTh Prishtinë dhe në PTh Ferizaj. Gjithashtu ka filluar përgatitja e informatave në përgjigje të kërkesës së Komisionit Evropian lidhur me inputin e Nënkomitetit për Drejtësi, Liri dhe Siguri, si dhe janë zhvilluar aktivitete lidhur me organizimin e takimit koordinues me donatorë. Nga ana tjetër, është bërë përditësimi i databazës së

seancave gjyqësore, janë koordinuar aktivitetet e projektit holandez CILC dhe janë ofruar një mori komentesh në draftin e Planit të Veprimit të Agjendës për Reformë Evropiane për vitin 2021-2022, duke vazhduar me përgatitjen e draftit të Raportit të auditimit për Divizionin e Prokurimit dhe janë mbështetur administratorët dhe udhëheqësit e njërive lidhur me çështjet rreth personelit, duke koordinuar punët në zbatim të vendimit të Qeverisë.

Rrjedhimisht është bërë edhe koordinimi i pjesëmarrjes në trajnime online të organizuara nga IKAP për personelin dhe në një takim tjetër me administratorë të prokurorive janë diskutuar çështjet që kanë të bëjnë me planifikimin e nevojave dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me financa dhe shërbime të përgjithshme. Është prezantuar drafti i Rregullores për menaxhimin e procesit të punës përmes SMIL-it (versioni 2).

Është mbajtur takim online me zyrtarët ligjorë të Prokurorisë Themelore në Ferizaj dhe është diskutuar krahasimi i Raportit statistikor të lëndëve PPN, të përgatitur në mënyrë manuale dhe ka filluar pilotimi i largimit të regjistrimit fizik për PPN. Është përgatitur dokumenti i cili përshkruan projektet në fushën e TI-së, të cilat janë të nevojshme për sistemin prokurorial. I njëjti dokument do të prezantohet para donatorëve për financim. Është mbajtur takim me stafin e International Management Group- IMG dhe është diskutuar procesi i pranimit teknik të pajisjeve në Qendrën e të Dhënave në Pallatin e Drejtësisë dhe pranimin e kodit burimore të SMIL. Kemi filluar përgatitjen e manualit për ngritjen e nivelit të sigurisë së të dhënave për stafin e sistemit prokurorial të Kosovës.

Është vizituar Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), për çështjet e auditimit. Është ofruar përgjigje në kërkesën e Komisionit Evropian lidhur me inputin e nënkomitetit për drejtësi, liri dhe siguri. Janë ofruar komente e KPK-së në konkluzionet e Komitetit për Stabilizim Asociim. Janë zhvilluar aktivitete lidhur me organizimin e takimit koordinues me donatorë. Është dhënë opinion ligjor për Komisionin përzgjedhës të rekrutimit lidhur me ekzistimin e mundshëm të konfliktit të interesit. Është përgatitur Raporti i Zyrës për Komunikim për Zbatimin e Planit të Punës së ZKPSH-së për tremujorin e parë të vitit 2021. Janë koordinuar aktivitetet e projektit holandez CILC, ku janë bërë përgatitjet për trajnimin me udhëheqësit e njërive të administratës me temë: “Menaxhimi, transparenca, dhe llogaridhënia, i cili do të mbahet më 26 maj 2021. Ka filluar me identifikimin e nevojave buxhetore për sistemin prokurorial për

periudhën 2022 dhe vlerësimet e hershme për periudhën 2023-2024. Është përgatitur dokumenti i cili përfshin komentet lidhur me draft raportin e auditimit të jashtë për “Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve për KPK dhe KGJK”. Është përgatitur raporti lidhur me sfidat të cilat janë duke u shfaqur gjatë shkëmbimit elektronik të të dhënave në mes prokurorisë dhe policisë dhe është organizuar takimi me menaxhmentin e Policisë së Kosovës. Është zhvilluar në SMIL ndarja e departamenteve për Prokurorinë Speciale sipas vendimit të KPK përfshirë edhe shpërndarjen automatike të lëndëve. Është publikuar versioni real i sistemi elektronik për menaxhimin e buxhetit e-financa. Me kërkesë të kryeprokurorit të PTH të Mitrovicës është përgatitur plani për ritrajnimin e stafit për përdorimin e SMIL për prokuror dhe staf mbështetës. Është mbajtur takim me përfaqësuesit e projektit EukoJust dhe është diskutuar ofrimi i mbështetjes në përgatitjen e planit strategjik të TI si dhe për ndërtimin e Qendrës së rimëkëmbjes në Prokurorinë Themelore Gjakovë. Përkritazi me njoftimin e pranuar nga ASHL, për përhapjen e emailave keqdashës janë ndërmarrë të gjitha masat e rekomanduara si dhe është ofruar përkrahje teknike përmes telefoni dhe email-it për stafin të cilët kanë hasur në emaila të tillë. Është bërë pranimi teknik i pajisjeve në Qendrën e të dhënave në Pallatin e Drejtësisë të cilat kanë qenë donacion nga Ambasada Norvegjeze. Është mbajtur trajnimi për Menaxhim, komunikim dhe bashkëpunim të organizuar në kuadër të projektit “Mbështetje për një sistem prokurorial të pavarur, profesional dhe të paanshëm në Kosovë” me ekspertë holandezë.

Aktivitetet e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë

Në kuadër të aktiviteteve të zhvilluara në maj nga ana e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë, aktivitetet e Zyrës për Mbikëqyrje, Analitikë dhe Verifikim Prokurorial kanë qenë të përqendruara në hartimin e Raportit analitik për tetë (8) vepra penale karakteristike në departamentet për të mitur për periudhën 2017-2020, mbledhjen dhe përpunimin e shënimeve statistikore për hartimin e raportit për rastet e dhunës në familje, koordinimin e proceseve të punës dhe hartimin e raporteve lidhur me përputhshmërinë dhe saktësinë e shënimeve nga regjistri fizik dhe ai i SMIL-it për lëndët e ndryshme penale (PPN) për Prokurorinë Themelore në Ferizaj, hartimin e Raportit informues për përputhshmërinë e shënimeve statistikore mes regjistrimit fizik dhe lëndëve të raportuara nga prokurorët individualisht në PTH

Gjakovë për periudhën janar-prill 2021, mbështetjen e procesit të rekrutimit, transferimeve dhe avancimeve të prokurorëve si dhe procesit të emërimit të Kryeprokurorit të PTH Gjakovë përmes zyrtarit të caktuar për realizimin e këtyre proceseve, mbështetjen e Komisioneve të Këshillit dhe proceseve të tjera të punës së Këshillit, përmes ofrimit të informatave të nevojshme për prokurorët dhe punën e prokurorive në përditësimin e vazhdueshëm të të dhënave në dosjet e prokurorëve, në hartimin e propozimprojektit për takimin e KPK-së me donatorë, vlerësimin e realizimit të aktiviteteve nga ZMAVP/NJSHPP, të cilat janë të përcaktuara me Planin e punës së KPK-së për periudhën janar-mars 2021, hartimin e raportit infografik për uebportalin e sistemit prokurorial për tremujorin e parë të vitit 2021 për veprat penale karakteristike, në takimet për avancimin e proceseve të punës në kuadër të grupit punues për reformën në administratën e sistemit prokurorial, takimin virtual për zhvillimin e raporteve të avancuara nga SMLL-i, pjesëmarrje në trajnime për zhvillimin e kapaciteteve menaxhuese dhe të komunikimit.

Zyra për Statistika ka përgatitur tetë (8) raporte të ndryshme me të dhëna statistikore për periudha të ndryshme kohore sipas kërkesave të Zyrës për Komunikim Publik dhe prokurorëve dhe ka përfunduar raportet për gjendjen numerike të lëndëve sipas llojit të regjistrave dhe departamenteve nëpër prokurori. Gjithashtu janë përfunduar raportet individuale për ngarkesën e prokurorëve me lëndë dhe efikasitetin në zgjidhjen e tyre për secilin prokuror veç e veç për muajin prill,

janë përgatitur format dhe janë përkthyer në gjuhën serbe, përmes të cilave grumbullohen të dhënat për punën e prokurorëve të nacionalitetit serb, të cilët i nënshtrohen procesit të vlerësimit, si dhe janë grumbulluar të dhënat statistikore për punën e 10 prokurorëve dhe të njëjtat i janë dërguar Komisionit për Vlerësimin e Përformancës së Prokurorëve. Dy zyrtarët e Zyrës për Statistika kanë kontribuar në punëtorinë treditore, të organizuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës në lidhje me Projektin statistikor "Zhvillimi i statistikave të krimeve dhe drejtësisë penale" IPA -2017. Kurse, me kërkesë të Kryetarit të Këshillit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në sport, prokurorit Besim Kelmendi, janë grumbulluar të dhëna të veçanta statistikore për veprën penale "Kurdisja e ndeshjeve ose sportit" nga neni 337 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës për vitet 2019, 2020 dhe TM1

2021. Po ashtu janë përgatitur të dhëna statistikore për veprat penale kundër integritetit seksual, nenet 227, 228, 229 dhe 236 KPK i ri, neni 230-232 dhe 243 KPK i vjetër për PTH të Prishtinës për periudhën 2011-2020 sipas viteve, sipas kërkesës së menaxhmentit të kësaj prokurorie dhe janë përgatitur të dhëna statistikore për gjendjen numerike të lëndëve për PTH Gjakovë për periudhën katërmujore janar-prill sipas llojit të regjistrave: PP, PPM, PPN, PPP dhe NJN dhe sipas departamenteve: DKR, DP dhe DM, për nevojat e Zyrës për Vlerësim. Gjatë muajin maj, prokurorët kanë marrë pjesë si pjesëmarrës në trajnime dhe në cilësinë e ligjëruesit për temat e ndryshme për prokurorë dhe gjyqtarë, në trajnimet, si në vijim: Programin e Trajnimeve të Vazhdueshme (PTV), Programin e Trajnimit për Trajnues (PTT), Programin e E-learning (ONILE), kurse stafi i prokurorive ka marrë pjesë në Programin e Trajnimeve të Vazhdueshme (PTV), të organizuar nga Akademia e Drejtësisë së Kosovës. Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnimeve të Vazhdueshme ka realizuar trajnimin përmes platformës zoom me temën "Program i specializuar: "Krimi Kibernetik - Sesioni I", qëllimi i të cilit ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve për krimin kibernetik si një aktivitet kriminal të zhvilluar në rrjet që ka si objekt apo si mënyrë të kryerjes së krimin keqpërdorimin e sistemeve kompjuterike dhe të dhënave kompjuterike. Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët dhe prokurorët e nivelit të Apelit dhe themeloreve.

Në bashkëpunim me Departamenti e Drejtësisë së SHBA-së/OPDAT - Ambasadën Amerikane, është realizuar tryeza e diskutimeve "Shtjellimi i koncepteve kryesore të Udhëzuesit të KPSH-së për rolin dhe kontributin e prokurorit të shtetit në matjen e dënimit", qëllimi i të cilit ishte trajtimi i Udhëzimit për rolin dhe kontributin e Prokurorit të Shtetit në matjen e dënimit dhe ndërlihdjen e tij me udhëzuesit e miratuar nga Gjykata Supreme, me ç'rast përfitues ishin prokurorët e Apelit, PSRK-së dhe PTH të Prishtinës. Po ashtu, në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane në Zagreb dhe Akademinë Gjyqësore të Kroacisë, është organizuar për gjyqtarët webinar regjional për kriptovalutat, qëllimi i të cilit ishte prezantimi i koncepteve më të fundit për kriptovalutat dhe pasuritë e tjera virtuale. Webinar-in e udhëhoqën ekspertët e Ambasadës Amerikane në Kroaci dhe ekspertët e FBI-së. Përfitues ishin gjyqtarët e Departamentit Special, departamenteve të krimeve të rënda dhe departamenteve të përgjithshme, si dhe janë mbajtur edhe disa tryeza dhe punëtori të rëndësishme. Sa i përket E-Learning-ut, Akademia e

Drejhtësisë, pas një pune dhe bashkëpunimi të gjatë me NGO INJECT-in, ka përfunduar zhvillimin dhe lansimin e tri kurseve trajnuese online, të cilat do të jenë të qasshme 24 orë në platformën e mësimit në distancë të Akademisë E-learning, për përfituesit e saj (gjyqtarë, prokurorë, bashkëpunëtorë profesionalë, staf administrativ të gjykatave dhe prokurorëve dhe studentë të fakulteteve juridike). Kurset e zhvilluara prekin fushën e dhunës ekonomike, alimentacionit dhe ndarjes së pasurisë së përbashkët mes bashkëshortëve, tema këto, të cilat janë pak të shtjelluara, duke shtuar këtu edhe ndryshimet legjislative që kanë ndodhur.

Gjithashtu janë zhvilluar edhe trajnimet për stafin administrativ të sistemit prokurorial dhe një i tillë është zhvilluar në bashkëpunim me UNDP, me temën “Komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun”, trajnimi u realizuar në mënyrë fizike. Trajnues ishte Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun në SKPK, Astrit Kolaj. Qëllimi i këtij trajnimi është që pjesëmarrësit të zgjerojnë shkathtësitë e tyre në komunikim dhe të njohin perspektiva të reja nga fusha e komunikimit, kurse përfitues ishin zyrtarët përgjegjës për komunikim me media dhe publikun në prokuroritë e vendit dhe asistentët e kryeprokurorëve.